



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA	
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA	
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë - Ministry of Trade and Industry	
Nr. Org. Organizimit Unit	01
Nr. Faqeve Broj Stranica Number of Pages	1
Data Datum Date	11.04.19

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë - Ministarstvo Trgovine i Industrije - Ministry of Trade and Industry
Kabineti i Ministrit - Kabinet Ministra - Cabinet of the Minister

01.Ref. Nr.24

Prishtinë, 11.04.2019

Ministri i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4 dhe nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 10, 11, dhe 17 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare, Nr. 7/01 mars 2019), si dhe nenit 8 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 dhe Shtojcës 8 të Rregullores Nr. 02/2011 Për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive ,merr:

V E N D I M

1. Ndryshohet dhe plotësohet vendimi i datës 09.01.2018 me numër të referencës 01/12 për përcaktimin e taksave për të gjitha shërbimet që subjektet kërkojnë për tu pajisur me dokumentacionin e nevojshëm siç parashihet në Shtojcën 1 të këtij vendimi dhe me qëllim të realizimit të aktivitetit të tyre në fushën e tregtimit dhe shërbimeve me mallra strategjike.
2. Shtojca 1 e vendimit bazë ndryshohet ashtu që taksa për Certifikatën për Regjistrim në regjistër hiqet nga Shtojca 1 e vendimit bazë.
3. Ky vendim është pjesë përbërëse e vendimit të datës 09.01.2018 me numër të referencës 01/12.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Endrit SHALA

Ministër



Vendimi i dërgohet:

- Kabinetit të Ministrit;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Departamentit për Tregtinë me Mallra Strategjike;
- Departamentit Ligjor;
- Arkivit të MTI-së.